

Organizatat anëtare të AWEN:

- **Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim** (Tiranë);
www.gadc.org.al
Kontakt: +355 42 255 514; info@gadc.org.al;
- **Qendra Psiko-Sociale "Vatra"** (Vlorë);
www.qendravatra.org.al
Kontakt: +355 33 224 078; info@qendravatra.org.al;
- **Forumi Gruas Elbasan** (Elbasan);
www.forumigruaselbasan.org
Kontakt: +355 54 254 516;
forumigruaselbasan1991@gmail.com;
- **Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza** (Tiranë);
www.hotlinealbania.org
Linja Kombëtare Falas: 116 117
Kontakt: +355 4 22 33 408; luarasi@gmail.com;
- **Shoqata "Agritra Vision"** (Peshkopi);
www.agritra-vizion.com
Kontakt: +355 21 822 796; info@agritra-vizion.com
- **Shoqata e Grave me Probleme Sociale** (Durrës)
Kontakt: +355 52 234 600 qendrasociale@yahoo.com;
- **Shoqata "Gruaja tek Gruaja"** (Shkodër);
www.gruajatekgruaja.com
Kontakt: +355 22 241 154; gruajatekgruaja@gmail.com;
- **Shoqata "Jona"** (Sarandë); www.shoqatajona.org
Kontakt: +355 85 222 425; info@shoqatajona.org;
- **Shoqata "Unë Gruaja"** (Pogradec); www.unegruaja.org
Kontakt: +355 83 222 140; une_gruaja@yahoo.com;
- **Qendra për Nisma Ligjore Qytetare** (Tiranë);
www.qag-al.org
Kontakt: +355 4 22 59 795; avokatore@albmail.com;



Na kontaktoni:

AWEN – Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri

Adresa: Rr. 'Vaso Pasha', P.16, Shk. `14, Tiranë

Website: www.awenetwork.org

E-mail: info@awenetwork.org

Na ndiqni në Facebook: AWEN - Albanian Women Empowerment Network



Suedi
Sverige

Ky material është financuar nga Agjensia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim - Sida.



AWEN Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri

FUQIA E NJË ZËRI

www.awenetwork.org

Ky është AWEN

Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri - AWEN është krijuar në 1 korrik 2009 dhe regjistruar në gjykatë më 27 dhjetor 2011, si një nismë e tetë organizatave jo-fitimprurëse që punojnë në mbrojtje të të drejtave të grave, me mbështetjen e Fondacionit Suedez 'Kvinnan till Kvinna'. Themelimi i këtij rrjeti u bë një domosdoshmëri për të forcuar bashkëpunimin midis këtyre organizatave, për të rritur ndikimin e nismave të përbashkëta dhe për të fuqizuar lëvizjen feministe në Shqipëri. Që prej krijimit të tij, rrjeti ynë punon për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me fokus kryesor të drejtat e grave dhe vajzave, duke synuar fuqizimin e tyre social, ekonomik dhe politik.

Vizioni ynë

Një shoqëri ku gratë dhe vajzat gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre të njeriut.

Misioni ynë

Të punojmë së bashku për të fuqizuar gratë dhe vajzat nga pikëpamja sociale, ekonomike dhe politike, për të marrë pjesë dhe realizuar të drejtat e tyre, pavarësisht orientimit të tyre politik, fetar, nivelit arsimor, moshës, orientimit seksual, aftësisë së kufizuar, identitetit seksual, apo faktorëve të tjerë.

Çfarë bën AWEN?

Ne punojmë që të arrijmë qëllimet tona nëpërmjet:

- lobimit e advokimit të përbashkët në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- rritjes së informimit e ndërgjegjësimit rreth të drejtave të grave;
- ndërtimit të kapaciteteve të aktorëve të ndryshëm;
- monitorimin e zbatimit të legjislacionit në nivel vendor e qendror;
- si dhe raportimeve e hulumtimeve mbi mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave.

AWEN arrin qëllimet e tij si rrjet, duke shërbyer si një **forum për ndarje praktikash dhe njohurish**, si një **lehtësues për zhvillimin e kapaciteteve organizative**, si dhe **nëpërmjet menaxhimit të granteve**.

Mbështetësit dhe bashkëpunëtorët tanë

Qeveria Suedeze vazhdon të jetë mbështetësja kryesore e veprimtarisë së AWEN dhe organizatave anëtare. Që prej vitit 2016, me mbështetjen e Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim – Sida, AWEN po zbaton një program kombëtar (faza II) për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave në Shqipëri.

Ndër vite, AWEN është mbështetur edhe nga Kvinna till Kvinna nëpërmjet fondeve të Qeverisë Suedeze, Mediterranean Women Fund, Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Shqipëri – Programi i Granteve të Vogla, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Shqipëri, Koalicioni 'Drejtësi për të Gjithë'/USAID, UN Women Albania, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (Banka Botërore), Rrjeti WAVE, etj.

ANËTARET TONA

AWEN përbëhet nga dhjetë organizata që veprojnë në tetë zona të Shqipërisë nga veriu në jug, ku jetojnë dy të tretat e popullsisë shqiptare. Organizatat anëtare të AWEN përqendrohen në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave dhe zbatimin e përpjekjeve për barazi gjinore në Shqipëri.

Ato kanalizojnë punën e tyre në drejtime të ndryshme, si **informim dhe ndërgjegjësim, lobim dhe advokim** në nivel vendor e qendror, **ngritje kapacitetesh** të aktorëve vendorë, **monitorime dhe hulumtim, si dhe ofrimi i një pakete shërbimesh të specializuara mbështetëse** për gratë dhe vajzat viktime të dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore dhe trafikimit në të gjithë Shqipërinë. Këto shërbime përfshijnë:

- Këshillim dhe mbështetje psikologjike;
- Këshillim dhe përfaqësim ligjor;
- Strehim të përkohshëm dhe/ose afatgjatë në një strehëzatrezidenciale publike apo jo-publike në vend;
- Paketë shërbimesh ri-integruese;
- Formim profesional dhe ndërmjetësim për punësim;
- Shërbim psikologjik rehabilitues për burrat dhunues;
- Ndërhyrje të tjera mbështetëse e fuqizuese.

